



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4876 Prot.

Roskovec, më 26.06. 2026

VENDIM

NR. 32 DATË 25.06 2026

PËR

DHËNIËN E TITUJVE "QYTETAR NDERI" TË BASHKISË ROSKOVEC

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, përkatësisht neni 9 pika 1.7 gërma a), neni 54 pika m); Ligjit nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë"; neni 8, neni 9 pika 1, neni 11 pika 2, neni 13 si dhe të VKM-së nr. 861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medalieve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë"; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Miratimin për Dhënien e Titujve "Qytetar Nderi" të Bashkisë Roskovec, si më poshtë :

a. Siku Spiro Kola me motivacionin:

"Për kontributin e shquar në çështjen kombëtare, si pjesëmarrës në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912, për angazhimin në mbrojtjen e kufijve të vendit, veprimtarinë patriotike dhe rolin e tij në organizimin e pushtetit vendor gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, si dhe për shërbimin me përkushtim ndaj komunitetit të Roskovecit, duke lënë një trashëgimi të vyer historike dhe atdhetare për brezat."

b. Thanas Dhimitër Kristuli me motivacionin:

"Për kontributin e çmuar si farmacist dhe veprimtar në shërbim të shëndetit publik, për përkushtimin profesional dhe human në ndihmë të qytetarëve të Roskovecit, për pjesëmarrjen dhe mbështetjen e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, si dhe për ndershmërinë, profesionalizmin dhe vlerat qytetare që la si trashëgimi në komunitet."

2. Ngarkohet Komisioni Këshillimor për Dhënien e Titujve Vendorë të Nderit për kryerjen e procedurave përkatëse dhe zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

